

**ADTN sha**

**Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

## 1. Informacion i përgjithshëm

ADTN sh.a ("Shoqeria") është themeluar më 13.09.2016, regjistruar më 21.09.2016 në QKR.

Më 31 dhjetor 2021 pronësia e kapitalit zotërohet 100% nga Digitalb sha .

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është ndërtimi dhe tregtimi i sistemeve të telekomunikacionit, i aparaturave per sistemet e transmetimit, shitja e produkteve audio dhe video dhe transmetim televiziv ne platformen numerike dhe me pagese.

Administrator i Shoqërisë është Z. Andi Cenko.

Shoqëria drejtohet nga Këshilli Mbikqyrës i cili përbëhet nga :

- Ardit Skënduli
- Manjola Shaska
- Dritan Kadiu

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT L62121006Q. Selia qëndrore e saj është në Rrugen "Pavarësia", Nr. 39, Kashar, Tiranë.

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2021 është 10 punonjës ( 2020: 14 punonjës ).

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

### 2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligji nr.25/2018 datë 30 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

### 2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### 2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### 2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitura në Lek, e cila është dhe moneda funksionale e Shoqërisë.

### 2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitura e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financier, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimesht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjera duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të janë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen.

Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale.

Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë pëershruar më poshtë:

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

### **2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësimë bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### **2.5.2. Provizonet**

Provizonet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste Shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

## **2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël**

Sic paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare sic kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

## **3. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### **3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2021	2020
EUR/LEK	120.76	123.70
USD/LEK	106.54	100.84

#### 3.2. Instrumentat finansiarë

Instrumentat finansiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat finansiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi që lidhet me to, përveç së pëershruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaktionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat finansiarë jo-derivativë maten së pëershruhet më poshtë.

Një instrument finansiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet finansiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finansiar ose kur shoqëria transferon aktivin finansiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve finansiare kontabilizohen në datën e transaktionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet finansiarë çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

##### Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

##### Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferençë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë përiudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### .2. Instrumentat financiare (vazhdim)

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

##### *Kapitali*

Kapitali njihet me vlerën nominale.

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njoftes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### .3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

#### .4. Aktive afatgjata materiale

##### i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

##### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### *iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Aktivet afatgjata materiale (AAM) paraqiten në bilanc me vlerën e tyre bruto minus amortizimin e akumuluar. Shtesat e Aktiveve Afatgjata regjistrohen në kontabilitet me koston e marrjes ose të prodhimit të tyre.

Ksto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë atë aktiv në vendin dhe kushtet ekzistuese. Normat e amortizimit të aplikuara janë sipas kërkesave fiskale dhe nuk marrin në konsideratë vlerësimin e amortizimit sipas jetës së dobishme të aktivit.

Për llogaritjen e amortizimit janë aplikuar këto norma amortizimi:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortizimit në %		Metoda e llogaritjes
	2021	2020	
Aktive jo materiale	15%	15%	Metoda lineare

Llogaritia e amortizimit për AQT e hyra gjatë vitit bëhet duke filluar nga data një e muajit pasardhës.

##### *iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

### 3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtarëve ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përvëç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

### **3.7. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

### **3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### **3.9. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përvèç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshmë të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 eshte 15%

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferençën e tatimit mbi fitimit të pagueshmë (apo të rikuperueshmë) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferençat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferençën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferençat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferençat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshmë të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

### **3.10. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiscale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridikcionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

### **3.11. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjeter, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjeter. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.12. Provizonet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukset e pritshme të parash për shlyerjen e tij. Provizonet përcaktohen duke skontuar fluksen e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizonet rimerren.

#### 3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënimë të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënimë për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financier dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

### 5. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Mjete monetare në bankë	1,953,391	102,722,070
Vlera në arkë	-	45,110
<b>Total mjete monetare</b>	<b>1,953,391</b>	<b>102,767,180</b>

### 6. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Klientë	-	174,272,006
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>174,272,006</b>

**7. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Tatim fitimi i parapaguar	1,247,704	400,000
Të tjera llogari të arkëtueshme	-	95,812
<b>Totali</b>	<b>1,247,704</b>	<b>495,812</b>

**8. Parapagime dhe shpenzime të shtyra**

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Shpenzime te shtyra	93,198	-
<b>Totali</b>	<b>93,198</b>	<b>-</b>

ADTN sha  
Shënimet e passqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021  
(Vlerat janë në Lek)

**9. Aktive Afatgjata Jo Materiale**

	Licensa kompjuterike	Totali
<b>Kosto</b>		
Gjendja më 1 janar 2020	-	
Shtesa	1,883,554	1,883,554
Pakësime	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>1,883,554</b>	<b>1,883,554</b>
 Shtesa	 -	 1,883,554
Pakësime	-	1,883,554
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>1,883,554</b>	<b>1,883,554</b>
 <i>Amortizimi i akumuluar</i>	 -	 -
Gjendja më 1 janar 2020	138,971	138,971
Amortizimi i vittit	138,971	138,971
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>282,528</b>	<b>282,528</b>
 Amortizimi i vittit	 421,499	 421,499
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>421,499</b>	<b>421,499</b>
 <i>Vlera neto kontabël</i>	 1,744,583	 1,744,583
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>1,462,055</b>	<b>1,462,055</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>1,462,055</b>	<b>1,462,055</b>

### 10. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Furnitorë	82,593	246,746,669
<b>Totali</b>	<b>82,593</b>	<b>246,746,669</b>

### 11. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Detyrime ndaj shoqërisë Digitalb	6,680,563	37,260,163
<b>Totali</b>	<b>6,680,563</b>	<b>37,260,163</b>

### 12. Detyrime tativore

Detyrimet tativore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	202,082	409,954
Tatim mbi të ardhurat e personale	86,959	161,586
TVSH për t'u paguar	497,693	1,745,531
<b>Totali</b>	<b>786,734</b>	<b>2,317,071</b>

### 13. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Të tjera	30,320	-
<b>Totali</b>	<b>30,320</b>	<b>-</b>

### 14. Kapitali

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 është si mëposhtë:

	31 dhjetor 2021			31 dhjetor 2020		
	Nr.Aksioneve	Vlera nominale	%	Nr.Aksioneve	Vlera nominale	%
Digitalb sha	1	3,500,000	100%	1	3,500,000	100%
	<b>1</b>	<b>3,500,000</b>	<b>100%</b>	<b>1</b>	<b>3,500,000</b>	<b>100%</b>

# Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat janë në Lek)

## 15. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	48,947,667	49,789,294
Te ardhura nga shitja e mallrave / abonimeve	42,465,878	365,210,121
<b>Totali</b>	<b>91,413,545</b>	<b>414,999,415</b>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	31 dhjetor 2021
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	91,413,545
Shtohen te ardhurat e tjera	5,834
<b>Shuma e qarkullimit e korrektuar</b>	<b>91,419,379</b>
Sipas Kontabilitetit	91,419,379
Diferenca	-

## 16. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura të tjera	5,834	-
<b>Totali</b>	<b>5,834</b>	<b>-</b>

## 17. Lënda e parë dhe shërbime direkte

Në këtë zë paraqiten kostojë e lënudeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Ato detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Licenca dhe shpenzime të rrjetit tokësor	30,173,666	31,015,294
Shpenzime për mallra dhe abonime	41,330,268	357,414,349
<b>Totali</b>	<b>71,503,934</b>	<b>388,429,643</b>

18. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Pagat e personelit	10,210,383	12,254,628
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,444,496	1,450,090
<b>Totali</b>	<b>11,654,879</b>	<b>13,704,718</b>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2021 është 10 (2020: 14).

19. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Qera	500,000	500,000
Komisione dhe tarifa bankare	54,656	36,020
Tatime dhe taksa vendore	112,100	112,100
Shpenzime konsulencë dhe auditim	2,091,235	553,710
Të tjera shpenzime	234,770	226,098
<b>Totali</b>	<b>2,992,761</b>	<b>1,427,928</b>

20. Shpenzimet financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit që lidhet me aktivitetin financier të Shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga interesat	14,410	-
<b>Totali</b>	<b>14,410</b>	<b>-</b>

## 21. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përllogarita e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>4,999,687</b>	<b>11,298,155</b>
Total shpenzime të panjohura	195,152	56,007
Penalitete, gjoba e dëmshpérblime	68,403	
Shpenzime të tjera	126,749	
<b>Fitimi para tatimit (përfsfirë shpenzimet e panjohura)</b>	<b>5,194,839</b>	<b>11,354,162</b>
 <b>Humbje fiskale e mbartur</b>		 (20,015,851)
<b>Tatim fitimi @15%</b>	<b>779,226</b>	<b>-</b>
<b>Fitimi i vitit</b>	<b>4,220,461</b>	<b>11,298,155</b>

## 22. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.